



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:125056

Datë: 19.08.2024

Numri i dokumentit: 06063567

P.nr.163/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit F.B. nga Vushtrria, për shkak të veprave penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.626/18 e datës 06.09.2018, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 15.08.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Vyrtyte Gërvalla, i pandehuri F.B. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av. XH.M., më datën 15.08.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.08.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F.B. nga i ati A., e ëma L., e gjinisë M, data e lindjes ...në Vushtrri, me vendbanim në Vushtrri, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, edhe më parë i gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 362 paragrafi 1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK),

Për veprën penale I, të përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës:

REFUZOHET AKUZA

I SEPSE: Me datën 24.10.2017 rreth orës 18:50 minuta, në rr. “Aziz Zhilivoda” në Vushtrri, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike ashtu që gjatë aksionit “STOP DROGËS NËSHKOLLË”, gjatë kontrollës së rregullt, policia ka vërejtur një automjet të llojit “Ford”, ngjyrë e zezë me targa 02-522-CF dhe duke i'u afruar automjetit i pandehuri ka hapur derën e automjetit dhe e ka hedh një qese të vogël me shtatë pako të substancës narkotike – marihuanë të përzier me tetrahidrokanabinol në sasi prej 9.26 +- 0.0001 gram të cilat policia i ka sekuestruar

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

URDHËROHET- Konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike – marihuanë të përzier ne tetrahidrokanabinol në sasi prej 9.26 +- 0.0001 gram

Për veprën penale II të përshkruar si në dispozitivin e aktakuzës,

ËSHTË FAJTOR

II SEPSE: Prej datës dhe vitit të pa përcaktuar e gjerë më 24.10.2017 në shtëpinë e vete, në dhomën e gjumit në Vushtrri rr. “Sulejman Vokshi” ka poseduar municion 47 plumba të kalibrit 7.62 mm, pa leje përkatëse sipas Ligjit për armët RK, të cilat janë gjetur dhe sekuestruar nga ana e policisë gjatë bastisjes

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 47, 73, 74, 275 par.1, par.3 dhe 374 par.1, par.3 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364 dhe 449 të KPPK-së, e,

G J Y K O N

Për pikën II të dispozitivit i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej dymijë e pesëqind (2500) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

URDHËROHET- Konfiskimi i përhershëm i municionit të përberë nga 47 plumba të kalibrit 7.62.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.626/18 e datës 06.09.2018, kundër të pandehurit F.B. nga Vushtrria, për shkak të veprave

penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

I. Për pikën I të dispozitivit është refuzuar aktakuza pasi që në seancën e shqyrtimit fillestar dhe atë me datë 15.08.2024 prokuroja e shtetit tërhiqet nga ndjekja penale për shkak se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale dhe atë më datë 24.10.2023, kjo pasi që vepra penale që i vihet në barrë të pandehurit është e dënueshme deri në 3 vjet burgim, ndërsa sipas nenit 106 par.1 pika 1.5 parashihet që parashkrimi relativ arrihet 3 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme më shumë se një vit burgim ndërsa dyfishi i këtij afati pra parashkrimi absolut ka arritur me datë 24.10.2023, andaj heqja dorë nga kjo pikë bëhet sipas standardit ligjor.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë sa i përket pikës II

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më datë 15.08.2024, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjti i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri F.B. ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thëllë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtton gjykatës që në të ardhmen kjo vepër nuk do të përsëritet më.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, i propozojmë gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që ky deklarim i tij vjen pas konsultimit me mbrojtësin e tij, andaj i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë si dhe është në përputhje me gjendjen faktike si në aktakuzë, gjykatës i propozon që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese ndërsa si rrethanë rënduese të merret rrezikshmëria shoqërore që paraqitë kjo vepër penale, mosbashkëpunimin me institucione e rendit dhe të verifikoj sipas detyrës zyrtare nga certifikata e evidencës penale nëse e njëjti ka të kaluar kriminale dhe nga ajo rezulton të mirët si rrethane lehtësuese eventualisht rënduese. Po ashtu mbesim pran propozimit të pikës III në aktakuzë lidhur me konfiskimit e pas pranimit të raportit shkatërrimin e sendeve që janë objekt i kësaj aktakuze.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av. XH.M. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pasi që ky pranim është bërë pas konsultimit me të njëjtin, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe i vetëdijshëm për pasojat dhe natyrën e pranimit të fajësisë, ashtu që i propozon gjykatës që të miratojë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij. Të marrën parasysh rrethanat lehtësuese me rastin e matjes së dënimit si pranimin e fajësisë, faktin se kanë kaluar shtatë vite nga koha e kryerjes se kësaj vepre penale ndërsa sa i përket kërkesës së prokurorisë që të sigurohet evidenca penale konsideroj se prokuroria është dashur ta ballafaqoj në seancë me të njëjtin. Sido që të jetë konsideroj që me një dënim më të butë do të arrihej efekti dhe qëllimi i këtij sanksioni penal.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit nr.2017-BD-1125, i datës 24.10.2017, raporti policor, i datës 24.10.2017, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, vërtetimi mbi hyrjen në banesë dhe lokale të tjera, i datës 24.10.2017, procesverbali mbi marrjen ne pyetje të dyshuarit F.B., i datës 24.10.2017, procesverbali mbi marrjen ne pyetje të dëshmitarit-ankuesi RR.S., i datës 24.10.2017, memorandum i zyrtar, i datës 30.10.2017, shënimi zyrtar, i datës 24.10.2017, raporti i ekspertimit, i datës 08.02.2018, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, 24.10.2017, fotoalbumi i përbërë në shtojcë prej 24 fotografive dhe skica e përgjithshme e vendit të ngjarjes.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 374 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen *“Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës, ndërsa për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, gjykata ka konstatuar se për këtë vepër është arritur parashkrimi absolut sipas nenit 106 par.1 pika 1.5 pasi që parashihet se parashkrimi relativ arrihet 3 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme më shumë se një vit burgim ndërsa dyfishi i këtij afati pra parashkrimi absolut ka arritur me datë 24.10.2023 dhe po ashtu prokuroja e shteti ka hequr dorë nga ndjekja në seancën e shqyrtimit fillestar dhe atë më datë 15.08.2024.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e rrezikshmërisë shoqërore që paraqitë kjo vepër

penale, mos bashkëpunimin me organet e rendit nga i pandehuri pasi që për të njëjtin gjykata ka lëshuar disa urdhër arreste, letër rreshtime ndaj të njëjtit, faktin që ka qenë edhe më parë i dënuar e cila është konstatuar nga evidencat penale edhe atë me aktgjykim me numër të rastit P.239/2017 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 me dënim me gjobë, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë në shumë prej dymijë e pesëqind (2500) euro për veprën e lartcekur, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Urdhrin për konfiskimin e substancës narkotike gjykata e ka marrë konform nenit 275 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen”, ndërsa urdhrin për konfiskimin e municionit, 47 plumba të kalibrit 7.62 mm, e ka marrë konform nenit 374 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet”.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.163/2023, datë 19.08.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit

Numri i lëndës: 2019:125056
Datë: 19.08.2024
Numri i dokumentit: 06063567

në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.